**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE DURRËS**

**NOTER JULED A. BEQIRAJ**
**ADRESA NR.4, EGNATIA**
**TEL: 684050555**

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

**Nr. repertori: 943** **Nr. koleksioni: 569**

**Durres më 16/02/2023**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

A2022011520478224978

*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë

A2022011520478224978

**KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI**

*( TË SHOQËRISË "Elite Studio" SH.P.K)*

Sot, më datë 16.02.2023, para meje Noter JULED A. BEQIRAJ, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Durres, NR.4, EGNATIA, u paraqit personalisht:

**SHITES:1-Astrit Bakiri,** atësia Beqir, amësia Feruze, shtetas Shqiptar, lindur në Durre dhe banues në Durres, me adresë Hysen Myshketa 00690344 Nd.30 H.6, Ap.15 Durres, lindur më 20/02/1951, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036864061 dhe nr. personal F10220137E, .

**BLERES:Shpëtim Canka,** atësia Seit, amësia Afërdit, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në DURRËS, me adresë Aleksander Goga 00690045; Nd. 42; H. 33; Ap. 9; Durrës; Durrës; 2004; Durrës, lindur më 10/03/1957, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035250209 dhe nr. personal F70310284K, .

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noteri konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noteri redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "Elite Studio" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

**OBJEKTI:** Transferimin e kuotave te *Të Shoqërisë "*Elite Studio*" SH.P.K* ne mbeshtetje te ligjit "Per shoqerite tregtare" i ndryshuar, neneve te Statutit te shoqerise ne masen 34%, qe i perkasin ortakut **Astrit Bakiri,** ne dobi te **pales blerese Z.Shpëtim Canka,** me vlere totale 50.000 leke (pesedhjete mije) leke.

Sipas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur deri ne diten e sotme të Shoqërisë "Elite Studio" Sh.p.k. rezulton se kjo shoqeri eshte regjistruar si person juridik me nr. NIPT-i L91721507E. Aktualisht ortaket e kesaj shoqerie, **Z.Orion Toska** posedojne 33% te kapitalit dhe **Z.Astrit Bakiri** posedon 34 % te kapitalit dhe **Shpëtim Canka** posedon 33% te kapitalit

Objekti i shoqerise eshte:"Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem: Ne fushen e projektimit, ,bikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve te zbatimit. Konsulences inxhinierike. Konsulences inxhinierike sipas termave nderkombetare, projektim arkitektonikdher urbanistik, projektim konstruktiv, instalator, vepra hidroteknike, ujesjelles, kanalizime, rruge, hekurudha, ura, vepra arti, sinjalistikes rrugore etj ".
Kjo shoqeri e ka seline ne Durres Lagjja nr.3, Rruga Egnatia, zona kadastrale 8514, nr pasurie 3/65 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 9901, date 14.4.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", te ndryshuar" dhe konkretisht nenit 10 ku thuhet se "Ne rastet e kalimit te kuotave me kontrate, kushtet dhe momenti i kalimit te titullit te pronesise mbi kuoten, si dhe kushtet e tjera te kalimit, perfshire momentin e pageses se çmimit, rregullohen nga kontrata", palet jane dakord qe:
Pronesia 33 % e kapitalit te kesaj shoqerie kalon nga **Astrit Bakiri,** ne favor te pales blerese **Z. Shpëtim Canka,** menjehere me nenshkrimin e kesaj kontrate, duke u bere keshtu ortak i Shoqërisë "Elite Studio" Sh.p.k ne masen 67%

A2022011520478224978

Pagesa totale ne vleren 50.000 leke (pesedhjete mije) leke, ne favor te ortakut **Astrit Bakiri,** do te behet cash me nenshkrimin e kesaj kontrate.
Me depozotimin e akteve prane QKB-se palet kane detyrimin te paraqesin ekstratin e shoqerise me ndryshimet perkatese ne te gjithe insitucionet dhe organet administrative ku kjo shoqeri ka ushtruar aktivitetin e saj dhe mbart te drejta dhe detyrime.
Kontrata pasi u lexua nga une noteri dhe u gjet sipas vullnetit te paleve nenshkruhet vullnetarisht ne prani te noterit nga shitesi dhe bleresi dhe une noteri legalizoj nenshkrimet sipas ligjit.
Kontrates i bashkelidhen dokumentet perberese te saj.

## DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

13.1 Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noterit.

13.2 Unë Noteri, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

13.3 Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**PALËT KONTRAKTUESE**

**SHITES**

**Astrit Bakiri**

Astrit Bakiri

**BLERES**

Shpëtim Canka

Shpetim Canka

**NOTER**
JULED A. BEQIRAJ